



VROJTIMI I AKTIVITETIT KREDITUES

Për tremujorin e dytë 2022

2

0

2

2

Korrik 2022

DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

Shënime të përgjithshme

Pyetësi i Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues synon të mbledhë opinionin e bankave tregtare lidhur me zhvillimet e tre muajve më të fundit në ofertën dhe kërkesën për kredi, si dhe pritjet e tyre për tremujorin e ardhshëm. Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues jep në mënyrë të përmbledhur perceptimet e bankave mbi ndryshimet në kushtet e ofertës për kredi - ilustruar nëpërmjet standardeve, kushteve e termave të kreditimit dhe kredive të miratuara, - si dhe mbi ndryshimet në kërkesën për kredi, si për bizneset ashtu edhe për individët. Kjo analizë bazohet në rezultatet e agreguara nga përgjigjet e dhjetë bankave, të cilat zotërojnë peshën më të madhe të stokut të kredisë së dhënë për sektorin privat.

Pyetësi, në vija të përgjithshme, ndjek praktikën e ndjekur nga Banka Qendrore Evropiane, por është i përshtatur me specifikat e tregut tonë të kredisë për sektorin privat. Paralelisht, ndryshe nga praktikat e tjera, seritë e treguesve janë testuar për praninë e sezonalitetit dhe, aty ku ky efekt shfaqet, seritë janë korrektuar. Për më shumë detaje, Pyetësin e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues së bashku me fjalorin e termave të përdorur në të, një material të shkurtër mbi rëndësinë e këtij vrojtimi, disa aspekte metodologjike, si dhe seritë e përdorura në analizë, i gjeni të publikuar në adresën:

https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues/

PËRMBLEDHJE

Bankat tregtare shtrënguan standardet e kreditimit për të gjitha kategoritë e bizneseve në tremujorin e dytë. Ato u shfaqën më prudence në kreditimin për bizneset në këtë tremujor, kryesisht si pasojë e rrezikut të perceptuar mbi situatën makroekonomike në përgjithësi dhe aftësinë paguese të bizneseve në veçanti. Bankat shprehën gjithashtu një tolerancë më të ulët ndaj rrezikut në financimin e investimeve, si pasojë e pasigurive të shtuara dhe luhatjeve të larta të çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare. Së bashku me standardet, bankat shtrënguan edhe kushtet e termat e kreditimit për bizneset në këtë tremujor. Krahas rrezikut të perceptuar lidhur me perspektivën e ekonomisë, edhe shtimi i kostove të fondeve, si pasojë e politikës monetare më pak akomoduese, kanë diktuar shtrëngimin e kushteve dhe termave të kreditimit në këtë tremujor. Kujdesi i shtuar i bankave në këtë tremujor u reflektua edhe në një shkallë më të ulët miratimi të kredive për bizneset. Nga ana tjetër, bizneset shfaqën kërkesë të lartë për kredi, për financimin e investimeve të planifikuara dhe të inventarëve e kapitalit qarkullues, në të gjitha kategoritë e madhësisë së biznesit.

Ndryshe nga bizneset, kriteret e miratimit të kredive për individët ishin më të relaksuara në tremujorin e dytë. Bankat lehtësuan standardet, e së bashku me to edhe kushtet e termat për kreditë e reja akorduar individëve. Shtimi i konkurrencës në sistemin bankar, së bashku me zhvillimet aktuale dhe perspektivën për tregun e banesave, kanë nxitur bankat të lehtësojnë politikën e kreditimit për individët në këtë tremujor. Nga ana tjetër, kërkesa për kredi vijoi të raportohet e lartë, si në kreditë për blerje banesash, ashtu edhe në ato konsumatore.

Në tremujorin e tretë, bankat presin tablo të ngjashme të kushteve të ofertës dhe kërkesës për kredi me tremujorin e dytë. Kështu, bankat pritët të mbeten të kujdesshme ndaj kreditimit të bizneseve, ndërkohë që pritët të mbajnë një përjasje më lehtësuese kreditimi për individët. Kërkesa për kredi, si nga ana e bizneseve ashtu edhe e individëve, pritët të jetë e lartë. Shtimi i kërkesës për kredi në të dyja kategoritë pritët të jetë me bazë të gjerë, edhe sipas qëllimit të përdorimit të kredisë.


KUSHTET E OFERTËS DHE KËRKESA PËR KREDI

1. KREDIA PËR BIZNESE

1.1. Standardet e kreditimit

Standardet e kreditimit për bizneset u shtrënguan në tremujorin e dytë të vitit 2022, kryesisht në sajë të shtrëngimit të tyre në kreditë akorduar për financimin e investimeve. Në terma të madhësisë së biznesit, standardet për kreditë e dhëna u shtrënguan në të dyja kategoritë, si për biznesin e vogël e të mesëm, ashtu edhe për atë të madh.


Grafik 1. Standardet e kreditimit për bizneset dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm¹



¹: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë lehtësim të standardeve, ndërsa ato negative shtrëngim të tyre. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Faktorët që sollën shtrëngimin e standardeve të kreditimit për bizneset në këtë tremujor ishin të lidhur më së shumti me perceptimin e rrezikut nga ana e bankave. Kështu, rreziku nga situata ekonomike në vend dhe perspektiva për të, nga aftësia paguese e kredimarrësit, si edhe nga kolaterali i kërkuar ndikuan në shtrëngimin e standardeve. Në të njëjtën kohë, toleranca më e ulët e bankave kundrejt rrezikut u raportua si një tjetër faktor që shkaktoi shtrëngimin e standardeve të kreditimit për bizneset.

Grafik 2. Faktorët me ndikim në standardet e kreditimit për totalin e bizneseve²



²: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve, ndërsa ato negative në shtrëngimin e tyre.


Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tremujorin e tretë të vitit 2022, bankat presin një tablo të ngjashme të standardeve të kreditimit me tremujorin e dytë (*Grafik 1*). Kështu, standardet e kreditimit priten të mbeten të shtrënguara, në të dyja kategoritë e madhësisë së biznesit. Po ashtu, edhe në terma të qëllimit të përdorimit të kredisë, standardet priten të vijojnë shtrëngimin, si në kreditë për financimin e investimeve, ashtu edhe në ato për mbulimin e nevojave për likuiditet.

1.2. Kushtet dhe termat e kreditimit

Kushtet dhe termat e përgjithshëm mbi kreditë e reja disbursuar bizneseve vijuan shtrëngimin në tremujorin e dytë të vitit. Shtrëngimi i tyre u arrit si nga elementet çmim, ashtu edhe nga ato jo-çmim. Kështu, bankat raportuan marzhe më të larta, sidomos mbi kreditë me rrezik; reduktuan madhësinë e kredisë akorduar bizneseve; parashtruan kërkesa më të larta për kolateral në raport me kredinë e dhënë; shkurtuan maturitetin maksimal të kredisë; si edhe shtuan numrin e kushtëzimeve në marrëveshjet e kredisë, të nënshkruara mes bankave dhe bizneseve.


Grafik 3. Ndryshimi i kushteve dhe termave të përgjithshëm në miratimin e kredive të reja për bizneset³



³: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë kushte dhe terma të lehtësuar, ndërsa ato negative të shtrënguar. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në gjykimin e bankave, shtrëngimi i kushteve dhe termave të kreditimit për bizneset u ndikua nga kostot e shtuara të bankave për fonde, perceptimi i tyre për rrezik të shtuar, si edhe nga toleranca më e ulët e bankave kundrejt këtij rreziku.

Grafik 4. Faktorët me ndikim në kushtet dhe termat e kreditimit për totalin e bizneseve⁴




⁴: Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e kushteve dhe termave, ndërsa ato negative në shtrëngimin e tyre. Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.3. Shkalla e miratimit të kredive

Shkalla e miratimit të kredive për bizneset u raportua më e ulët në tremujorin e dytë të vitit. Pjesa më e madhe e faktorëve që përcaktojnë shkallën e refuzimeve të kredive për bizneset kanë vepruar në kahun rritës. Kështu, perceptimi i bankave për rrezikun lidhur me perspektivën e sektorit ku operojnë bizneset, me gjendjen financiare të bizneseve; faktorët e lidhur me kuadrin e politikave të kreditimit të bankave, me aftësinë paguese të kredimarrësit; si dhe historiku i kreditit nga regjistri i kredive ndikuan në shtimin e numrit të refuzimeve për kredi gjatë këtij tremujori. Në kahun rënës të shkallës së refuzimeve të kredive u raportuan historiku i marrëdhënieve të biznesit me bankën, zotërimi i fondeve të bizneseve, si edhe statusi i kredive aktuale të bizneseve.

Grafik 5. Raporti i aplikimeve të refuzuara ndaj totalit të aplikimeve për kredi të bizneseve (majtas) dhe faktorët që kanë diktuar në vendimet e bankave⁵




⁵: Vlerat pozitive tregojnë rritje të raportit të refuzimeve ndaj totalit të aplikimeve për kredi (grafiku në të majtë). Po ashtu, vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në rritjen e raportit të refuzimeve (grafiku në të djathtë), ndërsa ato negative në reduktimin e tyre. Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.4. Kërkesa për kredi

Kërkesa për kredi e bizneseve vijoi të jetë e lartë edhe në tremujorin e dytë të vitit. Balancat e kërkesës për kredi shënuan vlera mjaft të larta pozitive, edhe këtë tremujor, si në kreditë për biznesin e madh, ashtu edhe në atë të vogël e të mesëm. Balanca e kërkesës për kredi në mbulimin e nevojave për likuiditete shënoi vlerën më të lartë historike. Gjithashtu, edhe kërkesa për kredi për financimin e investimeve u raportua e lartë në këtë tremujor.


Grafik 6. Kërkesa aktuale për kredi dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm për bizneset⁶



⁶: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë rritje të kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie të saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kërkesa e shtuar për kredi nga bizneset në tremujorin e dytë të vitit, sipas gjykimit të bankave, u ndikua kryesisht nga nevojat më të larta për financimin e inventarëve dhe kapitalit qarkullues, për financimin e investimeve, si dhe për refinancimin e borxheve ekzistuese. Po ashtu, niveli i përgjithshëm i normave të interesit u raportua si faktor favorizues. Nga ana tjetër, kreditë nga bankat e tjera, si edhe situata ekonomike në vend e perspektiva për të janë raportuar si faktorë me ndikim rënës në kërkesën për kredi të bizneseve në tremujorin e dytë.

Grafik 7. Faktorët që ndikuan në ndryshimin e kërkesës për kredi nga bizneset⁷



⁷: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka nxitur rritjen e kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënien e saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.


Bankat presin kërkesë të lartë për kredi edhe në tremujorin e tretë të vitit 2022, si nga bizneset e vogla e të mesme, ashtu edhe nga bizneset e mëdha (*Grafik 6*). Në prizmin e qëllimit të përdorimit, kërkesa për kredi pritet të jetë e lartë, veçanërisht për mbulimin e nevojave për likuiditet, ndërkohë që kredia për investime pritet të mbetet thuajse e pandryshuar nga tremujori i dytë.

2. KREDIA PËR INDIVIDË

2.1. Standardet e kreditimit

Standardet e kreditimit për individët vijuan lehtësimin edhe në tremujorin e dytë të vitit 2022. Lehtësimi i standardeve u vërejt në të dyja kategoritë e qëllimit të përdorimit të kredisë, si në kreditë për blerjen e banesave, ashtu edhe në atë konsumatore.


Grafik 8. Standardet e kreditimit për individët dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm⁸



⁸: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë lehtësim të standardeve, ndërsa ato negative shtrëngim të tyre. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Faktori kryesor që çoi në lehtësimin e standardeve të kreditimit u raportua të jetë konkurrenca e shtuar në sistemin bankar. Po ashtu, perceptimi i bankave lidhur me zhvillimet aktuale e të pritura në tregun e banesave, rreziku nga kolaterali, si edhe toleranca e bankave kundrejt rrezikut ndikuan në lehtësimin e standardeve të kreditimit në këtë tremujor¹. Në të kundërt me to veproi perceptimi i rrezikut lidhur me situatën ekonomike në vend dhe perspektivën për të.

Grafik 9. Faktorët me ndikim në standardet e kreditimit për totalin e individëve⁹



⁹: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve, ndërsa ato negative në shtrëngimin e tyre. Burimi: Banka e Shqipërisë.


¹ Këto balanca u shkaktuan kryesisht nga perceptimi i një banke të vetme të sistemit.

Në tremujorin e tretë të vitit 2022, bankat presin t'i lehtësojnë më tej standardet e kreditimit për individët, si në kreditë për blerjen e banesave, ashtu dhe ato konsumatore ([Grafik 8](#)).

2.2. Kushtet dhe termat e kreditimit

Kushtet dhe termat e përgjithshëm për kreditë akorduar individëve vijuan lehtësimin në tremujorin e dytë. Lehtësimi i kushteve dhe termave të kreditimit u arrit në sajë të aplikimit të marzheve më të ulëta mbi kreditë normale, të zgjatjes së afatit maksimal të maturitetit për kreditë dhënë individëve, si edhe të kërkesave më të ulëta për kolateral në raport me kredinë e marrë – në kreditë për blerje banesash –. Marzhet më të larta mbi kreditë me rrezik u raportuan si faktori i vetëm me ndikim shtrëngues në kushtet e termat e kreditimit për individët.


Grafik 10. Ndryshimi i kushteve dhe termave të përgjithshëm në miratimin e kredive të reja për individët¹⁰



¹⁰: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë kushte dhe terma të lehtësuara, ndërsa ato negative të shtrënguar. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Trysnia më e lartë nga konkurrenca në sistemin bankar, toleranca më e lartë e bankave kundrejt rrezikut, si edhe perceptimi për rrezik më të ulët u raportuan si faktorët që lehtësuan kushtet e termat e kreditimit për individët në këtë tremujor.

Grafik 11. Faktorët me ndikim në kushtet dhe termat e kreditimit për totalin e individëve¹¹




¹¹: Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e kushteve dhe termave, ndërsa ato negative në shtrëngimin e tyre. Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.3. Shkalla e miratimit të kredive

Bankat raportuan një shkallë miratimi të kredive për individët thuajse të pandryshuar nga një tremujor më parë. Në kahun rritës të shkallës së refuzimeve ndikuan të gjithë faktorët e lidhur me historikun e kreditit të individëve (statusi i kredive aktuale, historiku i marrëdhënieve me bankën, historiku nga regjistri i kredisë), mungesa e kolateralit, si edhe të ardhurat e disponueshme. Në të kundërt me to u raportua historiku i punësimit dhe stabiliteti i individëve në tregun e punës.

Grafik 12. Raporti i aplikimeve të refuzuara ndaj totalit të aplikimeve për kredi të individëve (majtas) dhe faktorët që kanë diktuar në vendimet e bankave¹²




¹²: Vlerat pozitive tregojnë rritje të raportit të refuzimeve ndaj totalit të aplikimeve për kredi (grafiku në të majtë). Po ashtu, vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në rritjen e raportit të refuzimeve (grafiku në të djathtë), ndërsa ato negative në reduktimin e tyre. Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.4. Kërkesa për kredi

Kërkesa e individëve për kredi u perceptua e lartë edhe në tremujorin e dytë të vitit, si për kreditë për blerjen e banesave, ashtu edhe për ato konsumatore. Në tremujorin e tretë të vitit 2022, bankat presin që kërkesa për kredi të jetë sërish e lartë, si ajo për blerjen e banesave, ashtu edhe ajo për financimin e konsumit.


Grafik 13. Kërkesa aktuale për kredi dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm për individët¹³



¹³: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë rritje të kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie të saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas gjykimit të bankave, rritja e kërkesës për kredi nga individët në tremujorin e dytë i atribuohet kryesisht nevojave të shtuara për kredi për financimin e blerjes së banesave. Gjithashtu, fushatat e ndërmarra nga bankat për kreditë konsumatore kanë nxitur shtimin e kërkesës për kredi në këtë tremujor. Niveli i përgjithshëm i normave të interesit, si edhe zhvillimet aktuale e të pritura në tregun e banesave janë raportuar si faktorë që kanë ndikuar në kahun rënës për kredi.

Grafik 14. Faktorët që ndikuan në ndryshimin e kërkesës për kredi për individët¹⁴



¹⁴: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka nxitur rritjen e kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënien e saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.